



21/11/2025

02/1318

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet Komunës së Shtimes dhe Organizatës Joqeveritare "Eco-Targeted (Eco-T)"

1. Palët Nënshkruese

Ky Memorandum Bashkëpunimi ("Memorandumi") lidhet ndërmjet:

1. Komunës së Shtimes

Me seli në Shtime

Përfaqësuar nga: Kryetari i Komunës, z. Qemajl Aliu

dhe

2. Organizatës Joqeveritare "Eco-Targeted (Eco-T)"

Me seli në Prishtinë

Numri i regjistrimit: 5113603-9


Data e themelimit: 15/09/2011

Përfaqësuar nga: Dardan Kelmendi, Drejtor Ekzekutiv

2. Qëllimi i Memorandumit

Qëllimi i këtij Memorandumi është të:

- Forcojë bashkëpunimin ndërmjet Komunës së Shtimes dhe OJQ Eco-Targeted;
- Promovojë zhvillimin e projekteve në fushat: ambient, mjedis, ujëra, energji, edukim dhe përfshirje komunitare;
- Mbështesë iniciativat e bazuara në dialog ndër-komunitar, aktivitete kulturore dhe informim qytetar;
- Krijojë bazë për projekte të përbashkëta në nivel lokal dhe ndër-institucional.



ECO-T



3. Fushat e Bashkëpunimit

Palët pajtohen të bashkëpunojnë në fusha që përfshijnë, por jo kufizohen në:

1. Projekte për përmirësimin e ambientit, gjelbërimin dhe pastrimin e hapësirave publike;
2. Iniciativa për mbrojtjen e natyrës, biodiversitetit dhe krijimin e zonave të mbrojtura;
3. Programe për menaxhimin e ujërave, ruajtjen e burimeve dhe reduktimin e ndotjes;
4. Projekte të energjisë së pastër, kursimit të energjisë dhe vetëdijesimit energjetik;
5. Punëtori, trajnime, ekspozita dhe aktivitete kulturore e ndër-komunitare për të rinjtë;
6. Mbështetje të ndërsjellë në përgatitjen dhe aplikimet e përbashkëta për grante;
7. Organizimin e eventeve me interes të përgjithshëm qytetar dhe zhvillim lokal.

4. Roli i Palëve

Komuna e Shtimes:

- Ofron mbështetje institucionale, administrative dhe logjistike;
- Koordinon aktivitetet në territorin e komunës;
- Bashkëpunon në lehtësim, promovim dhe implementim të projekteve.

OJQ Eco-Targeted (Eco-T):

- Harton projekte dhe iniciativa zhvillimore në fushën e mjedisit, edukimit, rinisë dhe ndër-komunitetit;
- Implementon aktivitetet e dakorduara me Komunën;
- Siguron raportim të vazhdueshëm për progresin;
- Ofron ekspertizë dhe kontribut profesional në projekte.

5. Kohëzgjatja

Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbetet i vlefshëm për tre (3) vite, me mundësi vazhdimi me marrëveshje të re të palëve.

6. Dispozita Përfundimtare

- Ky Memorandum nuk krijon obligime financiare të menjëhershme për asnjërën palë.
- Palët do të nënshkruajnë marrëveshje ose anekse të veçanta për projekte specifike.
- Memorandumi shpreh vullnetin për bashkëpunim të vazhdueshëm, të bazuar në transparencë dhe interes publik.




z. Qemajl Aliu
Kryetar i Komitetit



ECO-T


Dardan Keimendi
Drejtor Ekzekutiv

